




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	51338/21
Nr. i fq. / Br. st.	- 1 -
Data: / Datum:	21/09/21
VUSHTRRI - VUČITRN	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në Vushtrri, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 27.08.2021 me fillim në ora 14:00, në Shtëpinë e Kulturës-Vushtrri".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës etj.

Të pranishëm 93 pjesëmarrës. Prej tyre 87 meshkuj dhe 6 femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024
2. Takim me fermerët

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra në Vushtrri gjatë këtyre tri viteve të udhëheqjes së tij, si: shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Fermeri 1, thekson problemin me kanalizimin, pasi që edhe bagëtia nuk kanë ku të pijnë ujë shkaku i problemit me kanalizim.
2. Fermeri 2 , kërkon që fermerët ta kenë një zyre të tyre.
3. Fermeri 3, kërkon mbështetje më të madhe për bletarët.
4. Fermeri 4, kërkon mbështetje më të madhe për mbulimin e humbjeve të tyre duke i subvencionuar.

Në fund kryetari Tahiri, potencoi edhe politikat qeverisëse të tij në raport me fermerët, ku theksoi se plani ynë është që prodhuesit e qumështit t'i përkrahim me nga 4 cent për litër të qumështit të prodhuar, në këtë mënyrë do të ketë rritje të prodhimit të qumështit por edhe të krerëve të lopëve qumështore.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

